



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike!

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve, qe veprojnë ne Komunën e Klinës, programi i te cilave është i fokusuar në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë.

1. Komuna e Klinës –Drejtroria për Kulturë, Rini dhe Sport, duke u bazuar në: rregullore MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standarde t dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, u bënë thirrje të gjitha Organizatave Jo- Qeveritare, qe veprojnë ne Komunën e Klinës, programi i te cilave është i fokusuar në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë të aplikojnë për mbështetje financiare për vitin 2020.

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund t aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

Në fushën e sportit

- Zhvillimi i sportit në Komunën e Klinës
- Përkarhja dhe nggritja e nivelit profesional te klubeve sportive,
- Masivizimi i sportit për të rinj,
- Përkarhja për sportistët kulmori
- Ngritjen e nivelit profesional t klubeve sportive



Në fushën e kulturës:

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore.
- Promovojnë krijimtarinë lokale artistike;
- Promovojnë diversitetin lokal kulturor dhe nxisin dialogun artistik ndërkulturor;
- Promovojnë trashëgiminë kulturore;
- Kontribuojnë në shtrirjen e kalendarit kulturor përgjatë tërë vitit;
- Kontribuojnë në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;
- Nxisin pjesëmarrjen e audiencave të reja në jetën kulturore;
- Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike - kulturore, simpoziumet,dhe ekspozitat.
- Grupet/shoqëritë kulturore-artistike që funksionojnë n Komunën e Klinës,
- mbështeten bazuar n realizimin e suksesshëm t programeve t tyre kulturore

Në fushën e rinisë

- Fuqizimi i rinisë
- Mbështetja për funksionalizimin e qendrës rino
- zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejt për së drejti n nxitjen e aktiviteteve n luftimin e dukurive negative te të rinjtë;

- Mbështetje të personave me nevoja të veçanta

2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 5-anëtarësh, të cilët do ti vlerësojnë projektet në bazë të kritereve për vlerësim dhe sipas irregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimit te kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit te dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë se realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë se tij;

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:


- Formulari i aplikimit- Aplikacioni për projekt për OJQ- të
 - Formulari i buxhetit
 - Dokumenti identifikues;
 - Çertifikata e regjistrimit OJQ; Nr.fiskal, te jetë me selinë në Klinë;
 - Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
 - Dëshmi që ka dorëzuar raportin finansiar nga viti paraprak,
 - Konfirmim nga banka për xhirologarinë e aplikuesit.
4. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqe të Komunës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **26.05. 2020** deri më **16.06. 2020**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

5. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej **65.000,00 €**.
2. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e kulturës – për projektet në organizimin e festivaleve tradicionale është **500 €**, kurse shuma maksimale është **6.000 €**.
3. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet nga fusha e kulturës – për projektet tjera është **500 €**, kurse shuma maksimale është **8.000 €**.
4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet nga fusha e rinisë është **500 €**, kurse shuma maksimale është **3.000 €**.
5. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet nga fusha e sportit është **500 €**, kurse shuma maksimale është **30.000 €**.

Aplikimet

1. OJQ-të, në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt, për secilën nga fushat e thirrjes.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruar në regjistrin e organizatave



Jo-Qeveritare te regjistruara në Ministrinë përkatëse dhe te cilat veprojnë në Komunën e Klinës.

3. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Klinës - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

4. Dëshmi - Vërtetim te lëshuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që OJQ- ja ka kryer obligimet e vitit te kaluar.

5. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rrëth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Klinës

7. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Klinës

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ndërtesa e kuvendit Komunal Klinë

8. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fonave, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Vërejtje: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet e sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për Shqyrtimin e kërkesave.

Klinë, 26.05.2020



